



Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,

Duke marrë parasysh:

- Kompetencat e Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRRE) të dhëna në Nenin 14, 25 dhe 30 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 03/L-185);
- Nenin 4 dhe 6 të Rregullit për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë;
- Nenin 37 të Ligjit Nr.02/L-123 për Shoqëritë Tregtare, dhe
- Aplikacionin për licencë furnizim/tregti me energji elektrike të bërë me datë 12.01.2011 nga ndërmarrja "ENERGY FINANCING GROUP AD-Branch office in Kosovo" adresa: Dardania SU/1/6, H-1-8, Prishtinë, Republika e Kosovës.

Në seancën e mbajtur me datë 28 janar 2011, nxori këtë:

VENDIM

- I. I LËSHOHET** licenca për furnizim/tregti me energji elektrike ndërmarrjes ENERGY FINANCING GROUP AD-Branch office in Kosovo, me numër licence ZRRE/Li_37/11 për periudhën nga data **28 janar 2011** deri **28 janar 2013**.

Arsyetim

- ZRRE me datë 12.01.2011 ka pranuar nga përfaqësues të ndërmarrjes ENERGY FINANCING GROUP AD-Branch office in Kosovo, aplikacionin për licencë furnizim/tregti me energji elektrike.
 - ZRRE ka vlerësuar aplikacionin e kompanisë në fjalë, dhe bazuar në dëshmitë dhe dokumentet që kërkohen në Aplikacion për Licencë të Tregtisë me energji elektrike, ka kërkuar nga kompania në fjalë dokumente që mungonin.
 - Pas plotësimit të të gjithë dokumenteve dhe dëshmime të kërkuara sipas aplikacionit, ZRRE ka vlerësuar atë dhe duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.
- II.** Licenca i lejon të licencuarit që të kryejë vetëm aktivitetin e **tregtisë** së energjisë elektrike në Kosovë.
 - III.** Nëse i Licencuari ENERGY FINANCING GROUP AD-Branch office in Kosovo, dëshiron të zhvillojë edhe aktivitete të **furnizimit** me energji elektrike, të përcaktuara në Nenin 4 të licencës me Nr.ZRRE/Li_37/11, ai duhet të ri aplikojë, duke plotësuar kushtet që nevojitet për këtë aktivitet, sipas udhëzimeve të ZRRE-së.



- IV. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes midis versioneve, do të mbizotërojë versioni në gjuhën shqipe.
- V. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur mund t'i drejtohet Gjykatës Kompetente, brenda katërbëdhjetë (14) ditëve, nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të Vendimit në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i ZRRE-së

Dr. Ali Hamiti, kryesues

Përparim Kabashi, anëtar

Theranda Beqiri, anëtare

Blerim Koci, anëtar